

Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor (PMBU) për Basenet Ujore Drini-Buna dhe Seman është pjesë e Projektit Shqiptar për Mbështetjen Institucionale për komponentin e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore dhe Ujitjen (PBUU). PBUU financohet nga Banka Botërore, Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) dhe Qeveria e Shqipërisë, dhe është planifikuar të hedhë bazat për menaxhim më racional dhe të arsyeshëm të burimeve ujore

Për çdo basen ujor të identifikuar konform kuadrit ligjor KBU përkatës kryen një vlerësim në përputhje me nenet 24 dhe 36 të ligjit nr 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Këtë mission MBZHRAU, ST dhe KBU-te përkatëse të Drin- bunes dhe Semanit e zhvillojnë me asistencën BB dhe Sida-s, nëpërmjet një kompanie MOTT Mac Donald & Abkons me anë të një kontrate të firmosur në Qershor 2015 dhe duhet të përfundojë në Qershor 2017.

Procesi i miratimit parashikohet deri në fund të muajit Tetor 2017.

Komponentët e ToR-ve të kësaj kontrate janë:

1. Raporti Fillestar

- Raporti fillestar përmban një analizë paraprake dhe rrugët e mundëshme për t’u grumbulluar informacionet e nevojshme;
- Vlerësime dhe analiza që do të përfshihen në plan;
- Metodologjia dhe procesi për përgatitjen e PMBU;
- Formatit i propozimit për PMBU,
- Programe trainimi;

Raporti fillestar është dorëzuar nga konsulenti dhe është pranuar nga autoriteti kontraktues, MBZHRAU.

2. Raporti i Ndërmjetëm i PMBU në formatin e miratuar.

Në muajin Janar 2017 konsulenti ka dorëzuar draft raportin e ndërmjetëm. Ky draft është dërguar ST për komente.

3. Trainime

- Trainime për të diskutuar mbi kërkesat që duhet të plotësojë një PMBU ;

Jane zhvilluar 6 trainimet e para në të dy basenet respektive ;

4. Trainime në dy basenet ujore mbi modelimin

- Janë zhvilluar dy trainime nga 6 ;
- 5. Draft final PMBU në muajin Mar 2017 ;
- 6. Dokument i Planit Final në muajin Prill 2017 ;
- 7. Plani i Shpërndarjes ;
- 8. Raport i shkurtër përmbledhës

INSTITUCIONET E LINJËS:

Ministria e Drejtësisë ;
Ministria e Financave ;
Ministria e Shëndetësisë ;
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ;
Ministria e Zhvillimit Urban ;
Ministria e Integritit Evropian ;
Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ;
Ministria e Punëve të Brendshme ;
Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore ;
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve;
Enti Rregullator i Sektorit Të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura;
Sekretari Kombëtar i Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit, Pranë Kryeministrit.